

SHPRESA GJERGJI

**“RELATIVIZMI GJUHËSOR” TE FRAZELOGJIA E MOTIVUAR
NGA BOTA E KAFSHËVE NË FJALORË SHQIP- ANGLISHT
DHE ANGLISHT-SHQIP**

1. Gjuha dhe relativizmi gjuhësor

Sipas Humboldt, “Qëndrimi i njeriut ndaj realiteteve kushtëzohet tërësisht nga gjuha. Pra, njeriu e sheh botën e jashtme me sytë e gjuhës e si rrjedhim, edhe qëndrimi i njeriut ndaj botës varet nga gjuha. Humboldt-i, ndër të tjera, vëren se “Ndryshimet ndërmjet gjuhëve nuk janë çështje të tingujve dhe të shenjave, por të konceptit të ndryshëm mbi botën”¹.

Qeniet njerëzore e perceptojnë natyrën përmes kategorive të veçanta dhe secila kulturë e percepton realitetin në mënyra të ndryshme. Njerëzit i krijojnë fjalët dhe konceptet në mënyrë që të flasin për botën apo universin si pjesë e realitetit jetësor. Parimi i relativitetit gjuhësor nënkupton vlerësime të ndryshme të vëzhgimeve, të shfaqjeve (veprimeve) të ngjashme në dukje, por ende të diskutueshme, sepse vëzhguesit duhet të nxjerrin përfundime për këndvështrimet e ndryshme me të cilën e shohin dhe e perceptojnë botën.

Në themel të teorisë së Sapir Worf-it qëndron teza që përcakton se kufijtë që gjuha amtare vë për folësit e saj, janë në të vërtetë kufijtë e botës së tyre. Në teorinë e relativitetit gjuhësor fjalori dhe strukturat gramatikore të një gjuhe amtare kufizojnë dhe ndikojnë perceptimin për botën. Gjuha është një udhërrëfyes drejt realitetit gjuhësor, ajo kushtëzon fuqimisht të gjithë mendimin tonë për problemet dhe proceset shoqërore. Çdo gjuhë vulos një formë të veçantë të substancës së botës në të cilën flitet.²

Sh. Rrokaj shkruan se “që nga Humboldi, një grup gjuhëtarësh (Vartburgu, Trieja, Kasireri, Sepiri e Uorfi) kanë mbështetur tezën sipas së cilës çdo sistem gjuhësor vepron me një analizë specifike ndaj përvojës së bashkësisë. Ky proces kushtëzon mënyrën tonë të të konceptuarit të botës. Çdo gjuhë përfaqëson përvojën e bashkësisë sipas një mënyre të vetën, të dallueshme nga një gjuhë tjetër”³

2. Interpretimi i njësisë frazeologjike dhe shkalla e motivimit

Njësia frazeologjike vjen si një tërësi fjalësh me një kuptim të caktuar duke dhënë idenë e një kuptimi të drejtpërdrejtë apo të figurshëm, p.sh. *vari kokën, doli nga udha, e vuri me shpatulla për muri, doli në dritë, i bie legenit, rrugë qorre, ngre dorën, tund bishtin*, etj.

¹ W. Humboldt, *On the differences...* vep. cit., f. 47.


² S. Champan & S. Routledge, *Key ideas in linguistic and philosophy of language*, Edinburgh University Press, 2009, f. 30.

³ Sh. Rrokaj, *Strukturalizmi ...* vep. cit., f. 170-171.

Këto shprehje apo njësi frazeologjike vijnë si rezultat i kuptimit semantikor dhe shpesh si një domethënie e nënkuptuar. Duke na dhënë tablo kuptimore sipas konteksteve në përdorim, ato janë të lidhura me kuptimin e veprimit konkret apo me kuptim të brendshëm që s'ka lidhje me atë literal. Kuptimet e njësive frazeologjike me figuracion motivues, me figurat e metaforës apo krahasimit etj., klasifikohen si njësi frazeologjike të cilat derisa kanë ardhur në formën metaforike kanë kaluar në një proces relativisht të gjatë kohor, deri sa janë tashmë, shprehje të ngurtësuar me kuptim të ngulitur. Ashtu sikurse shprehet edhe Studiuesi Valter Memisha, “në shumë trajtesa ato janë parë si njësi që hyjnë të gatshme në ligjërim, që kanë si veçori parësore kuptimin e figurshëm të leksikalizuar”.⁴

Do të theksoja përkufizimin e Prof. J. Thomai: “Frazeologjia nis atje ku kuptimi i lirë leksikor i fjalës, mbulohet nga kuptimi i figurshëm i togfjalëshit të qëndrueshëm”.⁵

Le ta shohim konkretisht nëpërmjet skemës së klasifikimit të frazeologjisë për nga motivimi:



Figurshmëria dhe kuptimi i ri i fituar ka rritur aftësinë shprehëse të fjalës, sikundër e ka pasuruar me një kuptim të përforcuar dhe me ngjyrim të ri emocionues.

Shndërrimet metaforike të këtyre njësive jo vetëm që rrisin figurshmërinë dhe mjetet shprehëse të gjuhës, por edhe dëshmojnë për një njohje të plotë të të gjithë treguesve gjuhësorë dhe leksikorë në një gjuhë të caktuar, dhe si të tilla ato janë jashtëzakonisht të përdorshme e kuptimplota në ligjërim, dhe mjaft shprehëse si pjesë e pandarë e komunikimit.

Duke u mbështetur në tipologjinë e shpjegimit të kuptimit semantiko leksikor të tyre, mund të analizohen si nga formimi strukturor i tyre edhe nga ai i motivimit e kuptimit të brendshëm të tyre duke sjellë shembuj të tillë si:

⁴ V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, përmbledhje artikujsh, Tiranë 2011, f. 81.

⁵ J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.

“Relativizmi gjuhësor” te frazeologjia e motivuar nga bota e kafshëve...

“*zbriti nga mali*”, dygjymtyrëshe, njësi fr. e tipit foljor me kuptim të dyfishtë; 1) erdhi nga mali e zbriti në fushë ose 2) erdhi nga mali e s’merr vesh, s’di nga bota.

“*tund bishtin*”, dygjymtyrëshe, njësi fr. e tipit foljor, me kuptim të dyfishtë; 1) kafsha që tund bishtin, kuptim i një veprimi konkret ose 2) tund bishtin, këtu shohim një ndërthurje mes veprimeve të kafshës me atë të njeriut; kafsha ka bisht, jo njeriu. Kjo shprehje përdoret për të treguar se është femër e “lëvizur”, me kuptim të figurshëm. Kuptimi semantik është i lidhur me jetën dhe veprimtarinë njerëzore, pavarësisht se vjen si rrjedhojë e karakteristikave të kafshëve.

Aftësia për të abstraguar është e lidhur ngushtë me aftësinë që kanë folësit e një gjuhe për të njohur elemente të veçanta të realitetit objektiv, apo përbërës të caktuar të këtyre referentëve. Përzgjedhjet leksikore janë pikërisht dëshmi e perceptimit që individë folës kanë për botën dhe raportet që kjo bashkësi ndërton me realitetin nëpërmjet lidhjeve të shumta kulturore e shoqërore, që përfshijnë nivele të ndryshme të shprehura në ligjërim dhe të ndikuara nga mosha, gjinia, prejardhja, përvoja, statusi shoqëror e backgrounde të ndryshme socio-kulturore.

Shpesh figurshmëria vjen e motivuar edhe me krahasim, si p.sh: *ha si derr*-ha shumë; *turfullon si kalë*-është i inatosur; *flet si miza ne qyp*-flet me zë të ulët, etj. Këtu kemi parasysh përdorimin e lidhëzës krahasuese “si”, që na mundëson krahasimin, për të na dhënë një vlerësim apo cilësi në mënyrë që të arrihet një perceptim më i saktë në komunikim apo thjesht në ligjërim. Shihet qartë, që në kuptimin semantikor këto tipare e karakteristika të botës së kafshëve, shpesh janë prezente në përfytyrimin e kuptimit që ato përcjellin.

Rëndësia që merr përdorimi funksional i njësive frazeologjike, i jep kuptimësi më të plotë diskursit në bashkëbisedim, duke nënkuptuar atë që është e domosdoshme midis folësit dhe marrësit të mesazhit në këtë bashkëbisedim.

Frazeologjia është një nga pasuritë më të mëdha të gjuhës, me forcë të veçantë shprehëse dhe emocionuese. Të folurit e gjallë nuk mund të mendohen pa këtë lëndë të gjuhës shqipe. Ne shpesh në përditësinë tonë, flasim me metaforë, kështu duket se e përmbledhim më mirë mendimin.

3. Një përfaqje kuptimore e karakteristikave e tipareve të botës së kafshëve me veprimtarinë njerëzore

Vetë jeta, puna, situata të ndryshme, mënyra tradicionale e të jetuarit dhe e të kuptuarit, mësimet apo fjalori i të parëve, etj., na servirin momente ku ajo ç’ka thuhet, shpesh ka brenda nënkuptimin, në mënyrë që mendimi i brendshëm të shprehet nëpërmjet gjuhës së folur.

Prof. V. Memisha pohon se “një nga dukuritë më interesante gjatë shndërrimit të një togfjalëshi të lirë në njësi frazeologjike, është lëvizja semantike tek gjymtyra që shërben si krahasim, thelbi i saj semantik që shfaqet si temë motivuese në ngjizjen e njësisë frazeologjike, a ku zë fill figurshmëria. Larmia e motivimeve, – shpjegon Prof. Memisha, – është shumë e madhe, ashtu si është

gjithë bota. Edhe krijimi i njësive frazeologjike është i vazhdueshëm dhe i pashtershëm.”⁶

Një gamë e gjerë e këtyre njësive frazeologjike me intriguan mua, të përzgjedh këtë grup ku futen ato njësi frazeologjike të cilat në strukturën e tyre leksikore kanë në përbërje figurën, emrin apo cilësinë e një kafshe, e cila e bën këtë shprehje të ketë kuptim të figurshëm kur ajo përdoret në ligjërim dhe lidhet drejtpërsëdrejti me veprimtarinë njerëzore. Në këtë mënyrë, kuptim metaforik e sjell shprehjen të lidhur me botën e kafshëve dhe sjelljet e tyre, për të treguar ose nënkuptuar botën njerëzore, veprimtarinë njerëzore dhe sjelljet e njerëzve në mënyrë metaforike e të figurshme. Kështu ndërtime të tilla leksikore i gjejmë si:

- Njësi frazeologjike me fjalën **Kau** - *e do si kau kashtën*, (nuk e do fare, nuk e pëlqen); *qe si qe, u bë si ka*, (ndodhi si ndodhi); *si kau në arë/si kau në lëmë*, (vërtitet kot); *si kau balash*, (njihet menjëherë); *ka me një bri*, (i trembur); *kërkon kaun në gjë*, (aty ku nuk duhet); *e majm kaun ditën që do ta therë*, (e lë punën për në fund); *i pjell edhe kau*, (ka fat); etj.⁷

Por a janë këto shprehje, të tilla që, karakteristika nga bota e kafshëve u korrespondojnë njerëzve si cilësi apo shprehje të veprimtarisë së tyre njerëzore, edhe në gjuhën angleze? Njësi frazeologjike të tilla i gjejmë edhe në gjuhën angleze, shprehje kjo e relativizmit gjuhësor. p.sh.

“awkward as a cow on a crutch” / “awkward as a cow on roller skates” – *very clumsy or off balance, Tom will never be a gymnast; He is as awkward as a cow on roller skates!*

He runs like a cow on a crutch. – *shumë i ngathët, si i themi në gjuhën shqipe “i ha kokoshi qurrat”.*⁸

- Njësi frazeologjike me fjalën **kali** – *ta bësh dhembin sa të kalit*, (nuk fiton gjë sado të përpiqesh); *ra nga kali*, (ra nga pozita); *ka rënë shumë herë nga kali*, (ka kaluar shumë vështirësi, ka përvojë); *është hipur në kalë/ne maje te kalit*, (flet kaluar, i ka punët në rregull); *s’i kam hipur atij kali*, (nuk e kam nisur një punë); *i ka hipur kalit qorr*, (vepron qorrazi); *kalë azat/kalë i azdisur/kalë pa fre*, (njeri që është lënë i lirë); *kalë karroce*, (jo i zoti të vetëveprojë); *kalë i ngordhur*, (i dobët); *kali i qyqes*, (i pengon); **Kali i Trojës**, (armik i brendshëm); *sillet si kali në lëmë*, (vjen vërdallë kot); *shin si kali ne leme*, (bën ç’të dojë); etj.⁹

Të tilla njësi i gjejmë edhe në gjuhën angleze si shprehje e relativizmit gjuhësor, ku kuptimet semantike dhe nënkuptimet me domethëniet e idiomave, me karakteristika nga bota e kafshëve, në anglisht i gjejmë të pasqyruar në veprimtarinë njerëzore dhe të shprehura si p.sh.

⁶ V. Memisha, “Studime për fjalën shqipe”, përmbledhje artikujsh, Tiranë, 2011.

⁷ Njësi frazeologjike nga *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, J. Thomai, 1999.

⁸ Shprehje idiomatike nga McGraw-Hill’s American Idioms Dictionary, 4-th edition 2007.

⁹ Njësi frazeologjike nga *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, J. Thomai, 1999.

“Relativizmi gjuhësor” te frazeologjia e motivuar nga bota e kafshëve...

“*back the wrong horse*” – *to support someone or something that cannot win or succeed, - të zgjedhësh kalin e gabuar për të fituar. I don’t want to back the wrong horse, but it seems that Jed is the better candidate.*¹⁰

• Njësi frazeologjike me fjalën *qeni* – *bleu qen dhe i doli këlysh*, (i doli më pak, a më keq); *s’e ha as qeni*, (është shumë e keqe); *ka sa të hanë qentë*, (ka me tepri); *kur ha qeni petulla*, (në gjendje ekonomike shumë të mirë); *ha qen e shpend*, (ha gjithçka); *është për t’ua hedhur qenve*, (shumë e keqe, s’mund të hahet); *s’ka ku ta zërë qeni*, (është shume i varfër); *leh si qeni në hënëz*, (ankohet); *ku leh qeni e ku del tym*, (atje ku ka aheng); *luan qeni i kallajxhiut*, (bëhet zhurmë e madhe); *mbahet si qeni në qere*, (fryhet, kapardiset); *s’e njuh qeni të zotin*, (rrëmuje e madhe); *qen roje*, (i bindur); *qen bir qeni*, (njeri i poshtër); *si qen i lëshuar nga zinxhirët*, (i papërmbajtur), etj.¹¹

Në gjuhën angleze gjejmë ndërtime të tilla idiomatike si: “*bring a dog to heel*” – *to make a dog heel, (të vjen pas si qen, si qen i rrahur). A quiet command from his owner brought Fido to heel. “dog-eat-dog”- a situation in which one has to act ruthlessly in order to survive. (ha njeriu njerinë për të mbijetuar) It is dog-eat-dog in the world of business these days. “dog in the manger” – one who unreasonably prevent other people from doing or having what one does not wish them to do or have. If Martin were not such a dog in the manger, he would let his brother have that dinner jacket he never wears.*¹²

• Njësi frazeologjike me fjalën *lepur* – *u bë lepur/u bë si lepur*, (u urtësua); *e bëri lepur*, (e frikësoi shumë); *e di ku fle lepuri*, (ku qëndron e vërteta); *i ka futur lepurin në bark*, (e ka trembur shumë); *gjuan për lepuj*, (nuk punon, rri kot); *ka lepurin në bark*, (dridhet nga frika); *lepuri në mal e kusia në zjarr*, (prit kot); *rri si lepur në vresht*, (shumë i trembur); *nuk nxjerr lepur nga strofkulla*, (nuk është i zoti); *më erdhi lepuri në qere*, (më erdhi e mira te dera); *më erdhi lepuri në shteg*, (m’u krijua mundësia më e mirë); *zuri lepurin*, (u rrëzua); *e zë lepurin në lak*, (e kryej punën), etj.¹³

Në gjuhën angleze gjejmë shprehje idiomatike të tilla si: “*meat from a rabbit*” – *a cowardly person, (frikacak si lepur). He is a piece of meat from a rabbit.*¹⁴

• Njësi frazeologjike me fjalën *ujk* – *u bë ujk*, (u egërsua); *m’u bë ujk*, (m’u mërzi shumë); *të çaftë ujku/të preftë ujku*, (vdeksh); *ka fjetur me ujkun*, (është i egër e duhet t’i ruhesh); *si ujku në thekër*, (ra ngushte); *e pagoi si ujku me lëkurë*, (mori dënimin e merituar); *e shikon si ujku hënën*, (e ka inat); *e ka parë ujkun që i vogël*, (njeri i rrahur me jetën); *prej ujkut ra në gjarpër*, (shpëtoi nga një e keqe e ra në një tjetër); *është ujk me brirë*, (i vrazhdë, ters njeri); *është ujk*

¹⁰ Shprehje idiomatike nga McGraw-Hill’s American Idioms Dictionary, 4th edition 2007.

¹¹ J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999.

¹² McGraw-Hill’s American Idioms Dictionary, 4th edition 2007.

¹³ J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999.

¹⁴ McGraw-Hill’s American Idioms Dictionary, 4th edition 2007.

*deti, (detar i vjetër); ujk me lëkurë qengji, (njeri i pabesë); ujk i vjetër, (njeri i rrahur me jetën); etj.*¹⁵

Në gjuhën angleze gjejmë idioma të tilla që u korrespondojnë kuptime si: **“keep the wolf from the door”** – *to maintain oneself at a minimal level; to keep from starving, freezing, etc., (mezi, sa për të mbajtur shpirtin). We have a small amount of money saved, hardly enough to keep the wolf from the door.*¹⁶

Por shpesh gjejmë ndërtime të tilla në të dy gjuhët me gjegjëset e tyre të tilla si: *si bletë punëtore – as busy as a bee; dinak si dhelpra – as cunning as a fox; ha maja maja – eat like a bird; ha si kalë – eat like a horse; i urtë si qengj – as meek as a lamb; kokëfortë si mushka – as stubborn as a mule; vdesin si mizat – die like flies; ngul këmbë si mushka – dig one’s heels/dig one’s toes; i lehtë si pendë – as light as a feather; i fortë si kalë – as strong as a horse; etj. që siç shihen janë formime të quajtura idiomatike në gjuhën angleze dhe njësi frazeologjike në gjuhën shqipe, të motivuara me krahasim, dhe me përdorimin e lidhëzës krahasuese “si”(në shqip) dhe “as”/“like”(në anglisht).¹⁷*

Të tjera njësi frazeologjike me gjegjësen e tyre në gjuhën angleze shihen si ndërtime të motivuara me metaforë, të tilla si: *kalit të dhuruar nuk i shihen dhëmbët – beggars can’t be chooser; del nga strofa – break cover; nxjerr nga guacka – bring out of his shell; blej derr në thes – buy a pig in a poke; ku di dhia ç’është tagjia – cast pearls before swine; i pres krahët – clip sb’s wings; del nga guacka e vet – come out of one’s shell; i kreh bishtin – curri favor (with); iki me të katra – cut and run; fus hundët – dip one’s finger in sth; iki me të katra – do a bunk; ul pendët – drow in one’s horns; hedh shqelma (kunder dikujt) – kick against sth; e ha pas qafe – where the chicken gets the chooper; etj.,¹⁸ që siç shihet motivimi vjen nëpërmjet përdorimit të metaforikës së figurshme, që tregon se këto njësi frazeologjike a idiomatike janë semantikisht të figurshme e domethënëse me nënkuptimet e tyre.*

Si përfundim:

Njësia frazeologjike e motivuar nga emërtime nga bota e sjelljes dhe e karakteristikave të kafshëve, në lidhje me jetën dhe veprimtarinë njerëzore, zbërthimi i përbërësve semantikë të saj dhe kundrimi i dukurive gjuhësore në raport me realitetin objektiv dhe rrafshin e mendimit, sjell abstragime e nënkuptime në lidhje me jetën dhe individin që e përdorë atë në komunikim.

Njësia frazeologjike është një pasuri gjuhësore, që shpreh cilësitë shpirtërore të popullit, që e flet dhe tregon më së miri, se gjuha është një realitet i mendimit e perceptimit të njerëzve, të cilët nëpërmjet gjuhës i shprehin ato sipas mënyrës së vet, në një ndërveprim të pandërprerë me këtë realitet ku ata jetojnë.

¹⁵ J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, 1999.

¹⁶ McGraw-Hill’s *American Idioms Dictionary*, 4th edition 2007.

¹⁷ I. Stefanllari, *Fjalor idiomatik anglisht-shqip*, 1998.

¹⁸ I. Stefanllari, *Fjalor idiomatik anglisht-shqip*, 1998.

“Relativizmi gjuhësor” te frazeologjia e motivuar nga bota e kafshëve...

Rëndësia që merr përdorimi funksional i njësive frazeologjike, i jep kuptimësi më të plotë diskursit në bashkëbisedim, duke nënkuptuar atë, që është e domosdoshme midis folësit dhe marrësit të mesazhit në këtë bashkëbisedim.

Aftësia për të abstrguar, motivimi semantik i figurshëm, është i lidhur ngushtë me aftësinë që kanë folësit e një gjuhe, për të njohur elemente të veçanta të realitetit objektiv dhe për t'i ndërthurur ato në interesin e tyre në ligjërim, me përdorimin e njësive frazeologjike, në mënyrë që të arrijnë komunikimin e duhur, pavarësisht shkallës së motivimit që e bënë këtë komunikim me rezultativ.

Përzgjedhjet leksikore, ndërtimet e shumta të njësive frazeologjike në të dy gjuhët, anglisht-shqip, janë dëshmi e perceptimit që individët folës kanë mbi botën dhe format jetësore që ajo ndërton në raport me realitetin. Ky realitet, nëpërmjet lidhjeve të shumta sociale e kulturore, e përfshin dhe e shfrytëzon frazeologjinë në përdorimet e shumta në ligjërim. Marrëdhënia e njësive frazeologjike me këtë realitet dhe përdorimi i dendur nga folësit e saj, për sa analizuam me lartë, është gjithashtu shprehje e relativizmit gjuhësor për këto dy gjuhë (anglisht, shqip), anëtare të familjes së madhe indoevropiane, pavarësisht se i përkasin dy degëve të ndryshme të kësaj familjeje.

BIBLIOGRAFI

- A. Jashari, *Fjalor me shprehje te huazuara ne gjuhen shqipe*, Korçë, 2007.
A. Jashari, *Material frazeologjik nga krahina e Devollit*, SF, nr. 4, 1975.
A. Kostallari (1984), *Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë*, “Studime filologjike”, 4.
A. Kostallari (1989), *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, “Studime mbi leksikonin dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, III. Tiranë, f. 41-76.
A. P. Cowie, (1998), *Phraseology: Theory, Analysis and Applications*, Oxford, 1998.
B. Nerlich, *Semantic theories in Europe 1830-1930*, Philadelphia, 1992.
E. Sapir, *The status of linguistics as a science*. Language 5. 1929.
G. Lakoff & M. Johnson (1980), *Metaphors We Live By*, Chicago, London.
I. Stefanllari, *Fjalor frazeologjik anglisht - shqip*, Tiranë, 1999.
I. Stefanllari, *Fjalor anglisht-shqip*, Tiranë, 1986.
I. Stefanllari, *Fjalori frazeologjik anglisht-shqip*, 1998.
J. C. Ferdinand, *English Synonyms and Antonyms*, Funk and Wagnalls Company, London, 1907.
J. Gumperz; C. S. Levinson, *Rethinking Linguistic Relativity*, (December 1991).
J. Thomai (2003), *Shqipja standarde dhe leksikografia shqiptare*, Konferenca shkencore – Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot. Tiranë.
J. Thomai, *Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, Tiranë, 1981.
J. Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999.
M. Ndreca, *Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja*, Prishtinë, 2000.
McGraw-Hill's American Idioms Dictionary, fourth edition 2007.
Oxford advanced Learner's Dictionary of Current English, Oxford, 1977.
Oxford advanced learner's dictionary, Oxford, 2004.
OXFORD Advanced Learner's Dictionary, Sixth Edition by Sally Wehmeier, Oxford University Press 2000.

SHPRESA GJERGJI

- P. Griffiths, *An Introduction to English Semantics and Pragmatics*, Edinburgh University Press, 2006.
- P. Qesku, *Fjalor Anglisht-Shqip*, Botimet EDFa, Tiranë, 2000.
- S. C. Levinson (1983), *Pragmatics. Cambridge Textbooks in Linguistics*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Sh. Demiraj (1969), *Morfologji e gjuhës së sotme shqipe*. Tiranë.
- Sh. Rrokaj, *Filozofi e gjuhës prej Antikitetit deri në kohën e sotme*, Arbëria, 2010.
- V. Memisha (2006), *Rreth shndërrimit të tofjalëshit të lirë në njësi frazeologjike*, në "Studime filologjike", nr. 3 - 4.
- V. Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, përmbledhje artikujsh, Tiranë, 2011.
- W.V. Humboldt, *On the differences of the human Sprachbaues and its influence on the mental development of the human race*, Stuttgart, 1963.
- Z. Gjoçaj, *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë, 2001.